



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR
KËSHILLI BASHKIAK**



Adresa: Rr. 13 Dhjetori, Nr.1 Shkodër,

web: www.bashkiashkoder.gov.al

e-mail: keshilibashkiak@bashkiashkoder.gov.al

V E N D I M

Nr. 24, datë 30.3.2017

**Për miratim të vlersimit paraprak dhe masaës së shpërblimit për shpronësimin për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme pronë private që preken për efekt të investimit publik të objektit
“Rikonstruksion i bllokut të pallateve Xhabije”**

Këshilli Bashkiak Shkodër, në mbledhjen e tij të datës 30.03.2017, me propozim të kryetarit të bashkisë, mbështetur në nenin 9 pikë 1.2 shkronja “b”, nenin 54 shkronja “dh”, nenin 55 pika 3 të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ligjin nr 8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik”, i ndryshuar, VKM nr 127, datë 23.3.2000 “Për përmbajtjen dhe procedurat e paraqitjes së kërkeses dhe të njoftimit për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik”, VKM nr 89, datë 3.2.2016 “Për miratimin e vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë”, shkresës së ZVRPP Shkodër nr 283 prot, datë 17.1.2017, kontrata e sipërmarrjes me objekt “Rikonstruksion blloku i pallateve Xhabije”, projekt preventiv të miratuar, pas diskutimeve,

V E N D O S I :

1. Të miratojë vlerën e shpronësimit (truall+ndërtesë) për investime publike për objektin “Rikonstruksion i bllokut të pallateve Xhabije, me vlerë **23,638,296.3 lekë** (njëzet e tre milion e gjashtëqind e tridhjetë e tetë mijë e dyqind e nëntëdhjetë e gjashtë pikë tre), sipas pasqyrës bashkëngjitur.
2. Burimi i financimit për vlerën 23,638,296.3 lekë është fondi i trashëguar në programin 6260 “shërbime publike vendore” zëri investime-shpronësime.

3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.

4. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

Miraturar në datën 30.3.2017

Shpallur në datën 30.3.2017

Sekretar i këshillit



Suel Hadri

KRYETAR



Xhemal BUSHATI



Pasqyre e vlersimit te shpronësimeve te pronareve qe preken nga investimi per interes publik

Objekti: Rikonstruksion i bllokut te pallateve Xhabije

Nr	Emri Mbiemri (Pronari qe shpronësohet)	Indeksi i hartes	Nr. Pasuris e	Vol	Faqe	Siperfa qe totale m2	Nga kjo S.Truallit m2	Çmimi truallit leke/m2	Vlera e truallit leke	Siperfaqe ndertimi m2	Çmimi ndertese leke/m2	Vlera e nderteses leke	Vlera totale	Shenime
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	13	14	15	
1	Bujar Zeneli	SH-0-6	1/533	28	194	89.25	89.25			89.25	58,687.50	5,237,859.38	5,237,859.4	Konfirmim ZVRPP Shkoder
2	Martin Kodra		1/755	38	3	25.9	25.9			25.9	58,687.5	1,520,006.25	1,520,006.3	Konfirmim ZVRPP Shkoder
3	Lekë Lekaj		1/745			18	18			18	58,687.5	1,056,375.00	1,056,375.0	vertetim nga dok hipotekor
4	Vaçe Mlika Valbona Topaku	SH-P-6	1/790	38	115	37.9	37.9			37.9	58,687.5	2,224,256.25	2,224,256.3	vertetim nga dok hipotekor /
5	Ruzhdi Pjeshka Pranvera Pjeshka	SH-0-6	1/943	36			35	12,223	427805.0				427,805.0	vertetim nga dok hipotekor
6	Isuf Haxhia	SH-0-7	1/935	35	171		90	12,223	1100070.0				1,100,070.0	Vertetim nga dokumenti hipotekor
7	Ali Haxhija Emine Haxhija Ahmet Haxhija Fatime Çakiçi Albana Zeneli Anila Mesi						450	12,223	5500350.0				5,500,350.0	Vertetim nga dokumenti hipotekor
8	Esad Bushati	SH-0-6	1/546	30	97		6	12,223	73338.0				73,338.0	Konfirmim ZVRPP Shkoder
9	Afrim Bushi Emil Bushi	SH-P-6	1/356-ND	26	75	25.4		12223		25.4		745,719	745,719.0	Konfirmim ZVRPP Shkoder
10	Ejell Markaj	SH-P-6	1/23			226	28.75	12,223	351411.3	28.75		556,661	908,072.3	vertetim nga dok hipotekor
11	Eranda Naim Krymi Nertila Naim Xama	SH-P-6	1/766	37	137	30	30	12,223	366690.0	60		1,412,739	1,779,428.6	Konfirmim ZVRPP Shkoder
12	DZaudet Zagoviç	Sh-P-6	1/549	31	125	68.85	68.85	12223	841553.6	68.85		2,223,463	3,065,016.6	Konfirmim ZVRPP Shkoder

Shuma që shpronësohet											8,661,218			14,977,078	23,638,296.3
-----------------------	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	-----------	--	--	------------	--------------

Sekretar



Suel Hadri

KRYETAR



Xhemal BUSHATI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
QARKU SHKODËR
PREFEKTI

Pi. 5312/6 dt. 19.4.2017

Nr.400/1. Prot

Shkoder, më 14.04.2017

Lënda: Mbi vendimin nr. 24 datë 30.03.2017 të Këshillit të Bashkisë Shkodër.

Drejtuar: Këshillit të Bashkisë Shkodër

Prefekti i Qarkut Shkodër në zbatim të ligjit nr.107/2016, dt 27.10.2016 "Për Prefektin", neni 8, germa a, analizoi vendimin nr.24 datë 30.03.2017 të Këshillit të Bashkisë Shkodër "Për miratim të vlerësimit paraprak dhe masa e shpërblimit për shpronësimin për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtëshme, pronë private, që preken për efekt investimi publik të objektit "Rikonstruksion I bllokut të pallateve Xhabije",

Prefekti i Qarkut Shkoder, në zbatim të ligjit nr.139/2015 datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", neni 9, pika 1.2, germa b, neni 54, shkronja dh, neni 55/3, ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik", i ndryshuar, neni 7, 8 germa ç, nenet 9, 10, 11, VKM Nr.138, datë 23.3.2000 "Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përllogaritjes së masës së shpërblimit të pasurive pronë private që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të drejtave të personave të tretë, për interes publik", i ndryshuar, VKM nr.89, dt.3.02.2016 "Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë", shkresës të ZVRPP Nr.283.prot dt.17.01.2017, vkb nr.8 dt.30.01.2017 "Mbi miratimin e buxhetit te vitit 2017 dhe programit buxhetor-afatmesem 2018-2019 te Bashkise Shkoder, ju autorizon të procedoni, duke ju vënë ne dukje vonesen ne fillimin e procedurave per shpronësim si dhe duke kerkuar saktësi në hartimin e dokumentacionit shoqërues në plotësimin e formularit dhe relacionit konform procedurave te metejshme te parashikuara në ligjin nr.8561, datë 22.12.1999 "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik", i ndryshuar.

Me respekt,

